



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Liman (Beqir) Jasharit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 7206-1, Certifikata e pronësisë nr. P-71914059-07206-1, Zona kadastrale Prishtinë, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 7196-17, sip.1656m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-07196-17, Zona kadastrale Prishtinë, dhe parcela kadastrale nr.7168-5 , me sip.1041m², Certifikata e pronësisë nr.P-71914059-07168-5, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Liman (Beqir) Jasharit.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit zhvillimor urban " Arbëria 3 ", i miratuar me Vendimin nr. 01-35-94056, dt. 04.05.2015, me destinim përfshihet në infrastrukturë rrugore.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Liman (Beqir) Jashari, me kërkesën nr. 13-464/01-127700/20, ka kërkuar këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 7206-1, me sipërfaqe prej m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës (të propozuara nga gjeodeti) dhe pjesët e parcelave nr.7196-17, me sipërfaqe prej 1656m², dhe pjesën e parcelës nr. 7168-5, me sipërfaqe prej 1041m², Zona kadastrale Prishtinë në pronësi të Liman (Beqir) Jasharit.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarin e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit zhvillimor urban "Arbëria 3", miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-35-94056, dt. 04.05.2015, me destinim përfshihet në infrastrukturë rrugore.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 24 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, pasi komuna nuk ka pronë të vetën për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112330/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

